

VENDIM
Nr.525, datë 8.8.2007

PËR IDENTIFIKIMIN E KONCESIONIT PËR PROJEKTIN “PRODHI MI DHE SHPËRNDARJA E DOKUMENTIT TË IDENTITETIT DHE PASAPORTAVE ELEKTRONIKE”, PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.196, DATË 13.4.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT “PRODHI MI DHE SHPËRNDARJA E DOKUMENTIT TË IDENTITETIT DHE PASAPORTAVE ELEKTRONIKE TË SHTETASVE SHQIPTARË” DHE PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2007, MIRATUAR PËR MINISTRINË E BRENDSHME”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 5 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Identifikimin e koncesionit për projektin “Prodhimi dhe shpërndarja e dokumentit të identitetit dhe pasaportave elektronike”, në formën e propozimit të kërkuar.
2. Përcaktimin e Ministrisë së Brendshme si autoritetin kontraktues, për këtë projekt.
3. Pikat 2 dhe 3 të vendimit nr.196, datë 13.4.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e projektit “Prodhimi dhe shpërndarja e dokumentit të identitetit dhe pasaportave elektronike të shtetasve shqiptarë” dhe për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2007, miratuar për Ministrinë e Brendshme”, shfuqizohen.
4. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha